



Shkurt /Februar 2020

albanisch

Ata atëherë, treguan ç`u kishte ndodhur rrugës.

(Lk 24,35)

Kontakt: Meinolf Wacker
Kirchplatz 7
59174 Kamen

Tel.: +49-172-5638432
E-Mail: meinolf.wacker@go4peace.eu
Homepage: www.go4peace.eu

Tregomë!
Tell me!

Të dashur miq të fjalës,

Ishte në një stacion trenash natën vonë. Disa njerëz po bërtisnin me të madhe. Theresa po priste në platformën e trenit kur një grua e re iu afrua. Dukej shumë e pasigurtë dhe pak e lënë pas dore. Ajo ishte vetëm dhe dukej se kishte dëshirë të tregonte. Theresa vendosi të dëgjonte. Gruaja filloi të tregonte shumë gjëra të vështira që kishin ndodhur në jetën e saj. Theresa reagoi me kujdes ndaj asaj që gruaja tregonte. “Dhe si quhesh ti?”, e pyeti gruaja atë pas një farë kohe. Pasi treni i Theresës erdhi, ato u ndanë me një përqaftim. Dhe papritur kur kishte hipur në tren, Theresa dëgjoi emrin e saj: “Faleminderit, Theresa!” Por gruaja nuk dukej më pasi treni ishte nisur.

Kështu janë ndjerë edhe dy shokët e Jezusit rrugës për në Emmaus. Shumë gjëra të vështira kishin përjetuar gjatë rrugës, dhe Jezusi – shpresa e tyre – nuk ishte më aty me ta. Si do të vazhdonte tani e ardhmja? Kur papritur, një i huaj i afrohet dhe ecën me ta. Ai i pyet: “Çfarë janë këto gjëra për të cilat ju po flisni përgjatë rrugës?”. Ata i treguan atij gjithçka. Sa mirë të bën të tregosh! Zemra jote gjen përsëri paqen. Po afrohej mbrëmja dhe i huaji qëndroi edhe pak për të ndarë bukën me ta. Pastaj ata nuk e panë më.

Çfarë dhurate, të gjesh një vesh të hapur! Kur mund të tregosh me plot besim, atëherë gjen paqen në ty. Zoti na ka dhënë dy veshë, që të dëgjojmë më shumë sesa flasim. Kush dëgjon mirë, sjell paqen. Fto dikë që të tregojë, dhe pyete me kujdes. Pra, dhuroja një vesh dhe ftoje: **Tregomë! – Tell me!**

për OnWordTeam

Meinolf Wacker